

VENDIM
Nr.1075, datë 21.10.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS FARKË TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2,3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Farkë të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Farkë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.123, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Farkë të qarkut të Tiranës.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Farkë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Farkë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-8	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
9, 480	Monumente historike, buste me interes vendor&prona social-kulturore e sportive, zhvillim turizmi	Në pronësi
10-14	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të shëndetit publik	Në pronësi
15-50	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit	Në pronësi
51-63 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren në fushën e kullimit dhe ujitjes	Në pronësi
64-67,69-72,74-76,78-80,82-85,87-94	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë bujqësore)	Në përdorim
68,73,77, 81,86	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (tokë jobujqësore)	Në përdorim
95-452,471-479	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike	Në pronësi

470	Shërbime funerale	Në pronësi
-----	-------------------	------------